## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, **ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092***

**Një ankesë kundër:** KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 616-26-3555-1-1-1 dhe nr. I brendshëm 616-26-44-1-1-

Sa i përket tenderit për 165 Furnizimi dhe montimi i serrave nr i prokurimit

## ANKESË

### 1. Identifikimi i ankuesit*

(Nënshkrimi dhe vula)

**SHKELCEN SYLAJ B.I.**
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Skenderaj
(Adresa)
Skenderaj, Kosovë — 41000
(Vendi) — (Kodi postar)
+383 44 708 207
(Numri Telefonit) — (Numri i Faks-it)

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
shkelqensyla@gmail.com
(Adresa elektronike)

SHKELÇEN SYLAJ B.I
AGRO BORA
811021253 SKENDERAJ

**26.08.2026**
(Data e parashtrimit të kërkesës) — (Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

### 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

______________________________
*(Emri i avokatit)*

______________________________
*(Adresa e plotë)*

______________________________
*(Numri i Telefonit)*

______________________________
*(Numri i faks-it)*

______________________________
*(Adresa elektronike)*

______________________________
*(Data e parashtrimit të ankesës)*

______________________________
*(Nënshkrimi dhe vula)*

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

**SQARIM HYRES**

Njoftimi për kontratë është publikuar më datë **15.05.2026**,

Kerkese per sqarim :**01.06.2026**

Pergjigje nga AK- SQARIME SHTESË PËR OE me date:**02.06.2026**

Hapja e ofertave me datën **01.07.2026**

Formulari B58 – Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues është publikuar më **07.08.2026**

Kerekese per qasje ne dokumente me :**10.08.2026**

Lejimi I qasjes me:**10.08.2026**

Kerkese per qasje hera e dyte :**11.08.2026**

Lejimi I qasjes me:**11.08.202**

Kërkesë për rishqyrtim me 12.08.2026

Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim – refuzim sit e pabazuar me **18.08.2026 16:33 - dita e shtate.**

Sa i përket kriterit të vlerësimit, i njëjti ka qenë i përcaktuar si: "Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët", mbi bazën e të cilit është dashur të bëhet vlerësimi i ofertave dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues I cili I ploteson te gjitha kerkesat ne DT dhe ne Njotimin per kontrate.

**4. Procesi i Hapjes së tenderëve,** *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po** [x] **Jo** [ ]

Hapja e tenderëve është bërë përmes e-Prokurimit me datën **01.07.2026** në procesverbalin e hapjes nuk ishte evidentua ndonjë vërejtje

**5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,** *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

**Po** [ ] **Jo** [ ]

**6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**

*A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

**Po** [x] **Jo** [ ]

*Vendimi i Autoritetit Kontraktues është pranuar më datë* ***18.08.2026****, në ora* ***16:33*** *dhe nuk na ka njoftuar fare per zgjatje te afatit po ashtu nuk është respektuar as afati shtese.*

**7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit*

*për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Sipas ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës,i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:

1. Neni 1 Qëllimi i ligjit
2. Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
3. Neni 7 Barazia dhe trajtimi / Jo-Diskriminimi dhe Transparenca.
4. Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i tenderëve
5. Neni 60 Kriteret për dhënien e kontrates
6. Neni 64 i LPP-së – Dëshmitë dokumentare
7. Neni 65 i LPP-së – Pranueshmëria e kandidatëve ose tenderuesve
8. Neni 67 i LPP-së – Provat shkresore
9. Neni 69 Aftësia teknike ose/dhe profesionale
10. Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë dhe 43 I RRPP
11. Neni 19 i Rregullores Nr. 001/2022 – Specifikimet teknike

**Neni 62 -Refuzimi i një kërkese për shqyrtim**

**Neni 7 Informata Sekrete afariste dhe Qasja në Dokumentacion**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

*Në cilësinë e palës ne iteres kemi bërë Kërkesë për Rishqyrtim më datë 12.08.2026, Po ashtu ne cilësinë e palës ne interes po e parashtrojmë kete ankese ne OSHP kunder vendimit te AK ku i rekomanduar per kontrate eshte* ***OE "Berisha Construction" Sh.P. K,****çka e bën të pamjaftueshëm arsyetimin e Vendimit të nxjerrë nga Autoriteti Kontraktues ndaj Kerekseses per rishqyrtim dhe konsiderojmë se* eliminimi i Kompanise tonë është I pa drejte duke u bazuar ne kerkesat të Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit per kontrate pasi qe ne jemi OE I pergjegjeshem me cmim me te ulet ndërsa dokumentacioni i OE-së së rekomanduar është pranuar si I rregullt nga ana e AK-se pavarësisht mospërputhjeve, mangësive dhe dëshmive të pamjaftueshme të evidentuara gjatë qasjes në dokumente.
Për secilin pretendim do të paraqesim kërkesën konkrete të DT/NJK, dokumentin përkatës, shkeljen e konstatuar dhe arsyen pse vlerësimi i AK-së është i gabuar, i padrejtëdhe në kundërshtim me parimet e trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës së ndershme dhe përdorimit efikas të parasë publike.

**VENDIMI I AUTORITETIT KONTRAKTUES B58**
**bazohet ne pretendimet, të cilat i kundërshtojmë si në vijim:**

PRETENDIMI 1 - 1. Neni 1 Qëllimi i ligjit

1.Autoriteti kontraktues I juaj kontraktues nuk ka respektuar Neni 1 pika 1 e LPP-së, (Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase dhe transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, AK dhe komisioni i vlerësimit ka shkelur këtë nen të ligjit të prokurimit publik duke rekomanduar duke na shpallur të papërgjeshëm për dhënie të kontratës duke thene se OE që nuk i plotëson kriteret për dhënie të kontratës dhe duke na elminuar neve si Kompani e përgjegjeshme me qmim me te ulet .
Kjo tregon hapur se gjatë vlerësimit të tenderëve, AK ka shkelur nenin 1 të LPP-së si dhe nenin 4 të RRPP-001/2022

PRETENDIMI 2- Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Nuk është respektuar Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti (Autoriteti kontraktues është obliguar që të sigurojë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës

PRETENDIMI 3- Neni 7 Barazia dhe trajtimi / Jo-Diskriminimi dhe Transparenca.

Nuk është respektuar Neni 7 pika 1 e LPP-së, (Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminues dhe do të veprojë në mënyrë transparente, duke na diskriminuar ne si OE të përgjegjshëm me çmim më të lirë. AK dhe komisioni i vlerësimit ka vepruar në kundërshtim dhe nuk ka rrespektuar këtë nen të LLP-sëAK ka shkelur nenin 7 të LPP-së i cili ndër të tjera kërkon nga AK që gjatë ushtrimit të procedurave të prokurimit, t'i trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe duke mos favorizuar e as diskriminuar ndonjërin prej tyre.
Gjatë administrimit me këtë procedurë të prokurimit AK ka vepruar në kundërshtim të plotë me këtë nen pasi që edhe përkundër asaj që ne si OE jemi të vetmit që i kemi plotësuar të gjitha kërkesat nga Dosja e Tenderit, AK-në shkeljes mbi trajtimin e drejtë të OE.

PRETENDIMI 4-Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i tenderëve

Sipas ketij neni pika 1dhe 4 si vijon:

1. Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin
dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të
plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës. Me fillimin e zbatimit të prokurimit elektronik, KRPP-ja do ta nxjerrë legjislacion dytësor lidhur me këtë çështje.

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e
kontratës dhe në dosjen e tenderit

Duke iu referuar nenin 59 Autoriteti I juaj kontraktues ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve nuk i ka aplikuar saktë kërkesat e dosjes së tenderit duke shperblyer me kontrate OE I cili nuk I ka plotesuar keto kerkessa dhe duke na eleminuar neve si Operator ekonomik per arssye te cmimit me te larte. Arsyetimi i AK-së për mos shpërblim të tenderit tonë nuk lidhet aspak me realitetin dhe as me kërkesat dhe detyrimet që i jep nenin 59 i LPP-së. Sipas kësaj dhe njoftimit të AK-së shihet se AK nuk ka bërë vlerësim të drejte te tenderëve.

OE "SHKELCEN SYLAJ B.I "ka plotësuar të gjitha kërkesat në dosje të tenderit dhe në njoftimin pë kontratë dhe nuk ka mangësi në tenderin (ofertën e dorëzuar)
Sipas krejt kësaj që u tha më lartë, shihet qartë komisioni i vlerësimit ka shkelur plotësisht nenin 59 të LPP-së si dhe nuk ka respektuar fare kërkesat e dosjes së tenderit me rastin e cilësimit të OE" SHKELCEN SYLAJ B.I "te pasukseseshem.dhe rekomandimit te **OE "Berisha Construction" Sh.P. K**, e shtyjnë AK-në drejt shkeljes së plotë të nenit 59 të LPP-së si dhe drejt shkeljes edhe të dispozitave ligjore që flasin për administrimin e mirëfilltë të procedurave të prokurimit

PRETENDIMI 5 SHKELEJE E -NENI 64 I LPP-SË – DËSHMITË DOKUMENTARE dhe neni 65 I LPP-se

Një kandidat ose tenderues do të dëshmoj me certifikatë, vërtetim apo dëshmi të tjera të mjaftueshme të kërkuara në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues që: (i) arsyet për mos-kualifikim sipas nenit 65 të këtij ligji nuk zbatohen; (ii) të verifikojë përshtatshmërinë e tij profesionale, siç kërkohet nga Autoriteti Kontraktues sipas nenit 66 të këtij ligji; (iii) i plotësojnë kriteret e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues sipas nenit 68-71 të këtij ligji.

OE I rekomanduar per kontrate nuk I ka ploteuar keresat sipas nenit 65 , nenit 86-71 duke shkelur keto nene dhe nenin 65 pika 4.11 I cili ka ofruar dokumente te rreme ne kete aktivitet te prokurimit per te cilat do te japim arsyetim me posht.Neni 4.11. ka dhënë deklarata të rreme në lidhje me procedurën për dhënien e një kontrate publike, nëse këto kanë të bëjnë me mungesën e arsyeve për përjashtim, ose me përmbushjen e kritereve të përzgjedhjes.

PRETENDIMI 6 -Neni 65 i LPP-së – Pranueshmëria e kandidatëve ose tenderuesve dhe sipecifikimeve teknike Aneksi 1.

Kerkesat sipas nenit 65 dhe Ankesit 1 ne Dosje te tenderit ishin:

| **Kërkesat e përshtatshmërisë:** | ***Dëshmia e kërkuar dokumentare:*** |
|---|---|
| **1.Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga http krpp.rksgov.net** | **1.Deklaratën nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-042 , Plotësimi i Aneksit Nr. 2 te Dosjes se Tenderit** |

Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar një Deklaratë nën Betim e cila nuk përmban titullin dhe nr. te projektit/procedurës konkrete të prokurimit.

Mungesa e këtij elementi krijon një paqartësi serioze lidhur me atë se për cilën procedurë të prokurimit është hartuar dhe nënshkruar deklarata. Nga përmbajtja e dokumentit nuk mund të përcaktohet në mënyrë të qartë nëse deklarata është përgatitur posaçërisht për këtë aktivitet të prokurimit apo nëse është deklaratë e përdorur në ndonjë procedurë tjetër.

Nëse Dosja e Tenderit/Formulari i kërkuar nga Autoriteti Kontraktues përcakton se Deklarata nën Betim duhet të identifikojë aktivitetin e prokurimit, atëherë mungesa e këtij elementi përbën mospërputhje të dokumentit të dorëzuar me kërkesat e tenderit.
Për më tepër, duke qenë se bëhet fjalë për një deklaratë nën betim, identifikimi i qartë i procedurës për të cilën jepet deklarata është i rëndësishëm për të përcaktuar objektin dhe përgjegjësinë e deklaruesit.

2. Deklarata për specifikacionet teknike nuk përmban datën dhe nuk perkon me specifikat e ofuara nga ato te nenshkruara.

Në pikën 3.1 – Specifikacionet teknike të detyrueshme, Dosja e Tenderit përcakton:

"Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë:
a. Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit."

Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar një deklaratë për specifikacionet teknike, mirëpo kjo deklaratë nuk përmban datën e hartimit/nënshkrimit.

Mungesa e datës është veçanërisht relevante në rastin konkret, pasi deklarata paraqet një dokument dëshmues me të cilin OE deklaron përputhshmërinë e mallrave të ofruara me specifikacionet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.Perveq kesaj OE I rekomanduar ka deshmuar se do te ofroj deshmi sipas specifikave te Ankesit 1 ndersa ka ofruar deshmi tjera.

Në veçanti, kur një deklaratë nuk përmban as datën dhe, sipas rastit, as elemente të tjera identifikuese të procedurës, ekziston paqartësi objektive lidhur me kohën kur

është hartuar deklarata dhe nëse ajo është përgatitur posaçërisht për këtë procedurë.

### 3. Certifikatat ISO të skaduara

Një tjetër shkelje serioze është fakti se Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, "Berisha Construction", ka dorëzuar certifikata ISO të cilat, sipas verifikimit të tyre, rezultojnë me afat të skaduar.

Nëse Dosja e Tenderit ka kërkuar që certifikatat ISO të jenë valide në momentin e dorëzimit të ofertës dhe/ose gjatë periudhës së përcaktuar në dokumentet e tenderit, certifikatat e skaduara nuk mund të konsiderohen dëshmi për përmbushjen e kërkesës së përcaktuar.

Për më tepër, nëse certifikatat janë përdorur për të dëshmuar përmbushjen e kërkesave të përshtatshmërisë/kualifikimit të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, Autoriteti Kontraktues është dashur të verifikojë statusin dhe validitetin e tyre në momentin relevant të procedurës, para se ta rekomandojë OE për dhënie të kontratës duke vertetuar validitetin e tyre sipas kerkeses se vet AK.

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik është në fuqi në version të konsoliduar dhe përmban rregullat për dëshmitë dhe kërkesat e përshtatshmërisë së operatorëve ekonomikë.

Bazuar në sa më sipër, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë një vlerësim të plotë dhe objektiv të dokumentacionit të dorëzuar nga Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë.

Në veçanti, kërkohet të rishqyrtohen:

Deklarata nën Betim, e cila nuk identifikon projektin/procedurën konkrete të prokurimit;
Deklarata për specifikacionet teknike, e cila nuk përmban datën e deklarimit/nënshkrimit;
Certifikatat ISO, të cilat rezultojnë të skaduara dhe për rrjedhojë nuk dëshmojnë një certifikim valid në periudhën relevante të procedurës;
Për secilin nga këto dokumente, të verifikohet nëse përmbushen në mënyrë të plotë dhe të njëkohshme kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Shih Deklaratat:

"BERISHA CONSTRUCTION " SH.P.K
Nr.Unik 811242891 ; Adresa: Rr.Deshmoret e Kombit , Klinë
Tel Mob 045405211; Email: visari76@yahoo.de

DEKLARATË

Operatori ekonomik BERISHA CONSTRUCTION SH.P.K. konform kerkesave te FTD pika 3.1 :
OFRON

a. Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit;

| | |
|---|---|
| Nr i prokurimit | 616-26-3555-1-1-1 |
| Nr i brendshëm | 616-26-44-1-1-1 |

Titulli: 165 Furnizimi dhe montimi i serrave

BERISHA CONSTRUCTION SHPK

Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: BERISHA CONSTRUCTION SHPK deklaroj nën betim se jam i pershtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë Nr. 04/L-042 , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të Informacionit për Tenderuesit dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedure te prokurimit.

| Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE) | |
|---|---|
| Emri i OE: | BERISHA CONSTRUCTION SH.P.K. |
| Adresa e plotë: | RR.DESHMORET E KOMBIT , KLINE |
| I përfaqësuar nga: | |
| Emri: | VISAR BERISHA |
| Pozita: | Drejtor |
| Nënshkrimi: | |
| Data: | 01.07.2026 |
| Vula: | |

Te dy deklaratat nuk permbajne te dhenat e domosdoshme si titullin , nr e prokurimit dhe Deklarata mbi perbushjen e specifikave nuk permban daten e Nenshrkimit.

Pretendimi 7 shkelje e Neni 69-Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Mospërmbushja e kërkesës së kapacitetit tekniko-profesional – Kërkesa nr. 3 për cilësinë e folies

Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka dëshmuar përmbushjen e kërkesës së kapacitetit tekniko-profesional, Kërkesa nr. 3, të përcaktuar në Dosjen e Tenderit, lidhur me cilësinë dhe specifikacionin e folies së kërkuar.

Në mënyrë të qartë, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar se:"Kualiteti i folies duhet të jetë 180 MIC diffused (UV+EVA+LD+IR+AF)".

Nga formulimi i kësaj kërkese rezulton qartë se 180 MIC është specifikacion i përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues dhe jo një kërkesë minimale e shprehur me termin "minimum".

Është e rëndësishme të bëhet dallimi ndërmjet kërkesës për 180 MIC dhe kërkesës për 36 muaj. Në rastin konkret, termi "minimum" lidhet me kualitetin për periudhën 36 muaj, dhe nuk mund të interpretohet se i jep Operatorit Ekonomik të drejtën që të ofrojë një trashësi tjetër nga ajo e përcaktuar shprehimisht nga Autoriteti Kontraktues.

Pra:

180 MIC – është specifikacioni i përcaktuar për folien;
36 muaj – është kërkesa që lidhet me jetëgjatësine e folies;
këto dy kërkesa nuk mund të interpretohen si një kërkesë e vetme ku OE mund të ofrojë çfarëdo vlere të MIC mbi një minimum të supozuar.

Për më tepër, kjo kërkesë nuk është përcaktuar vetëm në kuadër të kritereve të përzgjedhjes/kapacitetit tekniko-profesional, por është përsëritur dhe specifikuar qartë edhe në Aneksin 1 – Specifikimet Teknike të Detyrueshme, ku Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar karakteristikat e detyrueshme të mallrave që duhet të ofrohen.

Kjo e bën edhe më të qartë se bëhet fjalë për një kërkesë teknike të detyrueshme, e cila duhet të përmbushet pikërisht sipas specifikacionit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues dhe te nënshkruar nga OE.

OE ka dhene deklarate se përmbushjen reale të specifikacionit dhe jo specifika tjera ne Aneksin 1. Pra Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka paraqitur ndonjë specifikacion tjetër teknik jashtë kërkesave të Aneksit 1, i cili do të dëshmonte se ka ofruar një produkt me karakteristika të ndryshme nga ato të kërkuara.

Përkundrazi, OE ka nënshkruar dhe vulosur specifikacionet teknike me 180 mikron, duke pranuar në mënyrë të drejtpërdrejtë specifikacionin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.

OE ka paraqitur një karakteristikë tjetër nga 180 MIC, atëherë ekziston një mospërputhje e drejtpërdrejtë ndërmjet dokumenteve të ofertës.

Në një situatë të tillë, nuk mund të konsiderohet se kërkesa është përmbushur vetëm për faktin se OE ka nënshkruar dhe vulosur Aneksin 1 me specifikacionin 180 MIC. Duhet të vlerësohet se çfarë produkti është realish ofruar dhe dëshmuar nga OE në ofertën e tij.

Nëse, nga ana tjetër, OE në të gjitha dokumentet e ofertës ka deklaruar 180 MIC, por dokumentet dëshmuese nuk e konfirmojnë këtë karakteristikë.

Duke analizuar: Kërkesën nr. 3 të kapacitetit tekniko-profesional;Aneksin 1 – Specifikimet Teknike të Detyrueshme; pecifikacionin e folies të deklaruar nga OE; dokumentet teknike/dëshmuese të dorëzuara nga OE;
përputhshmërinë e karakteristikës 180 MIC diffused (UV+EVA+LD+IR+AF) me produktin realisht të ofruar; dhe dallimin ndërmjet kërkesës për 180 MIC dhe kërkesës për minimum 36 muaj.

Nëse nga dokumentacioni i ofertës rezulton se OE nuk ka përmbushur specifikacionin e detyrueshëm 180 MIC diffused (UV+EVA+LD+IR+AF), atëherë oferta nuk mund të konsiderohet në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe Aneksit 1.

**Shih kerkesen 3:**

| Kerkesa e AK | Deshmia dokumentare |
|---|---|
| **3.OE, duhet të deshmojnë për kualtietin për foli plastike minimum 36 muaj -180 MIC** | **3.Duhet të dorëzohen deshmitë si certifikatat e prodhimit dhe dudi doganor i cili deshmon së kompanitë mund të ofrojn këtë lloj të folisë plastike.** |

Ne lidhje me këtë kerkese OE ka dorezuar nje pro fature e cila nuk permban as pershkrim as cmim dhe nuk ka te bej fare me kerkesen e AK qe te deshmohet me profature apo fature spese kerkesa dhe deshmia e AK-se si me larte ishte qe te plotesohej nga OE me certifikatat e prodhimit dhe DUD doganor i cili deshmon së kompanitë mund të ofrojn këtë lloj të folisë plastike.
Shih profaturen dhe faturen e dorezuar e cila nuk lidhet aspak me kerkesen 3 si me larte.

Në lidhje me Kërkesën nr. 3, OE i rekomanduar ka dorëzuar një pro-faturë e cila nuk përmban as përshkrim të produktit dhe as çmim, dhe përmbajtja e saj nuk dëshmon në asnjë mënyrë përmbushjen e kërkesës së Autoritetit Kontraktues për folien 180 MIC diffused (UV+EVA+LD+IR+AF).

Ekziston edhe një çështje serioze që kërkon verifikim lidhur me lëshuesin e profaturës.

Në profaturën e datës 30.06.2026, në krye figuron:

**NPT "YAPRAK"**

dhe është paraqitur nrb: 80383959

Ndërkohë, nga të dhënat e paraqitura nga regjistri i ARBK-së, subjekti me këtë identifikim figuron me status **"Shuar"**, ndërsa regjistri evidenton ndryshimin e formës së biznesit:

- Si mund te leshoj nje profature, nje biznes tash me I shuar, sipas verifikimit ne ARBK.

Për më tepër, **AK nuk ka kërkuar që kjo kërkesë të dëshmohet me pro-faturë** apo **faturë**. Në mënyrë të qartë, AK ka kërkuar që dëshmia të bëhet përmes certifikatave të prodhimit dhe DUD-it doganor, me qëllim që të dëshmohet se OE-të kanë mundësi të ofrojnë këtë lloj të folies plastike.

DUD-i doganor i dorëzuar dhe fatura e inporitit sipas DUD-it, nuk përmban të dhënat e kërkuara për të dëshmuar specifikacionin teknik 180 MIC diffused (UV+EVA+LD+IR+AF) dhe, për rrjedhojë, nuk mund të konsiderohet dëshmi për përmbushjen e Kërkesës nr. 3

Gjithashtu, nga shqyrtimi i faturës së importit të bashkëngjitur, e cila është paraqitur me qëllim të verifikimit të karakteristikave të folisë plastike, përfshirë trashësinë prej **200 mikronësh**, konstatohet qartë se dokumenti nuk dëshmon të gjitha elementet minimale të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.

Në veçanti, në dokumentacionin e paraqitur mungon elementi **AF – Anti-Fog**, i cili është pjesë shprehimisht e kërkuar në specifikacionin teknik dhe përbën një karakteristikë të rëndësishme funksionale për folitë profesionale të destinuara për sera.




Ky element është veçanërisht i rëndësishëm për folitë profesionale të destinuara për sera. Gjatë punës së serrës krijohet kondensim në sipërfaqen e brendshme të folisë. Funksioni **AF (Anti-Fog)** ka për qëllim që uji i krijuar nga kondensimi të shpërndahet në mënyrë sa më uniforme në sipërfaqen

e folisë dhe të mos formojë pika të cilat bien drejtpërdrejt mbi gjethet dhe bimët.

Prania e elementeve të tjera në produkt nuk mund të konsiderohet si zëvendësim i elementit **AF**, përderisa Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar qartë minimumin e kërkuar:

**UV + EVA + LD + IR + AF.**

Për rrjedhojë, si nga DUD-i doganor, ashtu edhe nga fatura e importit e dorëzuar, **nuk dëshmohet në mënyrë të plotë dhe të verifikueshme se folia plastike e paraqitur nga Operatori Ekonomik i përmbush specifikacionet minimale të kërkuara në Dosjen e Tenderit.** Duke I verifikuar keto dokumnete, fatura e dorzuar eshte nderlidhur me dokumnetin doganor DUD me nr te njejt te fatures VTP2024000000287, nuk eshte inportuar foli plastike 180mic, dhe nuk deshmon elementin AF.

vatan®

N.P.T. YAPRAK A.Ş.
MAMUSA- KOSAVA
FAX NO: 00 381 29 273 0 73

INVOICE NO VTP2024000000287
INVOICE DATE 07.03.2024

COMMERCIAL INVOICE

| DESCRIPTION | QUANTITY ROLL | QUANTITY KG | UNIT PRICE EUR/kg | TOTAL EUR EXW |
|---|---|---|---|---|
| GREENHOUSE FILM DIFFUSED UV+IR+AB+LD+EVA 200MIC | | | | |
| 36 MONTHS 12 MTR WIDTH -1000 kgs/roll | 3 | 3.001,50 | | |
| 36 MONTHS 10,5 MTR WIDTH -1000 kgs/roll | 3 | 3.073,00 | | |
| 36 MONTHS 9,5 MTR WIDTH - 1000 kgs/roll | 2 | 2.030,00 | | |
| GREENHOUSE FILM DIFFUSED UV+IR+AB+LD+EVA 180MIC | | | | |
| 36 MONTHS 12 MTR WIDTH -1000 kgs/roll | 3 | 3.026,00 | | |
| 36 MONTHS 11,2 MTR WIDTH - 1000 kgs/roll | 3 | 3.116,00 | | |
| 35 MONTHS 10,5 MTR WIDTH -1000 kgs/roll | 2 | 2.061,00 | | |
| 36 MONTHS 9,50 MTR WIDTH - 1000 mts/roll | 2 | 2.041,5 | | |
| 36 MONTHS 8,2 MTR WIDTH - 1000 kgs/roll | 1 | 1.006,5 | | |
| 12 MONTHS 1 MTR WIDTH 17 MICRON -1000mt/roll | 237 | 4.387,3 | | |

Dokument: Unik Doganor

DEKLARATE

IM 4

2032

ZD HANI I ELEZIT TERMINAL

Referenca doganore

R 7738 11/03/2024

Manifesti 2024 6516

3 Formularët 4

1 1

5 Sendimet 1

6 Nr. pakove 9

7 Numri referues 2024 #186

2 Eksportuesi

VATAN PLASTIK SANAYI VE TICARET AS
SOGANLIK ORTA MAH E-5 YANYOL NO 14
SOGANLIK KARTAL ISTANBUL/TR

8 Marrësi / Importuesi Nr. 810584252

NPT Yaprak
PN MAMUSHE
PRIZREN

9 Personi përgjegjës financiar Nr. 810584252

NPT Yaprak
PN MAMUSHE
PRIZREN

10 Vendi XK

11 Vendi i MK

12 Detajet e vlerës 1.343.00

13 P.P.B. 0

14 Deklaruesi Nr. 810075732

DAKOSHPED SH P K
ADEM JASHARI NR 29 KATI2 NR 22
Prizren

15 Vendi dërgues/eksportues TURKIYE

15 V.E. TR

17 V.D. XK

16 Vendi origjinës TURKIYE

17 Vendi i destinacionit KOSOVA

18 Identiteti dhe nacionaliteti i mjetit transportues në arritje/nisje 34BD5733 34EGJ020 TR

19 no

20 Kushtet e dorëzimit EXW ISTANBUL/TR

21 Identiteti dhe nacionaliteti i mjetit aktiv transportues që kalon kufirin 34BD5733 34EGJ020 TR

22 Valuta dhe shuma e përgjithshme EUR 34.726 70

23 Kursi i këmbimit 1.0000000

24 Lloji 1 1

25 Lloji transportit 30

26 Lloji transportit 30 Transport

27 Transportuesi

28 Të dhënat financiare dhe bankare

29 Zyra doganore hyrëse/dalëse 2035 HANI ELEZIT TRAKA

30 Lokacioni i mallrave

31 Paketimi dhe përshkrimi i mallit

Shenjat dhe numrat - Nr i kontejnerit - Numri dhe lloji

Numri dhe lloji 9 PA Pakota

Film tjetër polietileni, me trashësi mbi 125 mikrometra

Filma prej polietileni(ruline) për përdorim në bujqësi bujqësi për mbulimin e serave të fojeve
Shiko info faqe. Gjithsej 23744.80kg

32 Artikull 1

33 Numri tarifor 39201089 00

34 Kodi origjinës TR

35 Pesha bruto (kg) 23.969 80

36 Preferenca TRMTL

37 Procedura 4000 000

38 Pesha Neto (kg) 23.744 80

39 Kuota

40 Dokumenti paraprak/deklarata përmbledhëse 1

41 Njësia plotësuese

42 Çmimi për njësi 34.726 70

43 M.V. 1

44 Inf. shtesë Dokumente Certifikata dhe Autorizime

1.343.00+0.00+0.00+0.00-0.00

D.SH. 380 934

380 VTP202400000287/DUD PJESOR

41 Rregullimi 1.000

46 Vlera Statistikore 36.069 70

47 Llog. taksave tjera

| Lloji | Baza e taksës | Norma | Shuma | MP |
|---|---|---|---|---|
| CD | 36,069 700 | 0.000 | 0.00 | 1 |
| VT | 36,069 700 | 18.000 | 6.492 55 | 1 |
| | Totali | | 6.492 55 | 1 |

48 Llogaria e pagesës

49 Identifikimi i depos

B DETAJET E LLOGARISË

| | | |
|---|---|---|
| Mënyra e pagesës | KESH | |
| Garancioni | 0.00 | EUR |
| Totali shtesë | 0.00 | EUR |
| Totali taksave | 6.492 65 | EUR |

C ZYRA E NISJES

50 Principali Nr.

51 Zyra zyrat e transitit vendi

52 Garancioni

53 Zyra e destinacionit dhe vendi

D KONTROLL NGA ZYRA DOGANORE E DESTINACIONIT

54 Vendi dhe data

ERZEN HE...

AGJENSION DOGANOR DAKOSHPED PRIZREN

Pretendimi 8 reth mos permbushjes se certifikates

OE në **vend të certifikatës së prodhimit**, OE ka dorëzuar një **Technical Data Sheet** (Fletë të të Dhënave Teknike) të datës **24.04.2021,** dokument i cili është i vjetër dhe, mbi të gjitha, përmban përshkrim dhe karakteristika të tjera të folies dhe të aditivëve, të ndryshme nga specifikacioni i kërkuar nga AK.

Pra, dokumentet e dorëzuara – pro-fatura, DUD-i doganor dhe Technical Data Sheet – nuk përbëjnë dëshmitë e kërkuara nga AK dhe nuk dëshmojnë përmbushjen e specifikacionit të detyrueshëm 180 MIC diffused (UV+EVA+LD+IR+AF).

Sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues është kërkuar që të dorëzohen dëshmi, përkatësisht **Certifikata e Prodhimit dhe DUD-i Doganor**, me të cilat duhet të dëshmohet se operatori/kompania është në gjendje të ofrojë pikërisht llojin e folisë plastike të kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Specifikacioni i kërkuar për folinë plastike është:

**UV + EVA + LD + IR + AF –**

dhe dokumentet e dorëzuara duhet të mundësojnë verifikimin e këtyre karakteristikave për produktin konkret të ofruar.

Autoriteti Kontraktues ka kërkuar DUD-in pikërisht si dëshmi që operatori mund të ofrojë këtë lloj të folisë. Për këtë arsye, dokumenti i paraqitur duhet të krijojë lidhje të qartë ndërmjet mallit të importuar dhe karakteristikave të kërkuara. Në rastin konkret, fatura e inporit dhe DUD-in doganor, kjo lidhje mungon.

Fatura e importit nuk dëshmon elementin AF, të kërkuar, konkretisht elementin AF – Anti-Fog.

AF është pjesë shprehimore e specifikacionit minimal dhe nuk mund të konsiderohet si element i pa rendesishem.

Produkti mund të posedojë elemente ose aditivë shtesë, por këta elementë shtesë **nuk mund të zëvendësojnë një element minimal të kërkuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit**.

Prandaj, nëse dokumenti që dëshmon importin konkret nuk përmban AF (Anti Fog), atëherë nga ai dokument nuk mund të konstatohet se folia e importuar është folia e kërkuar sipas specifikacionit të tenderit, pasi qe ne faturen e mallite gjithnje specifikohen produket e porositura dhe te paguara, kjo tregon shume kjarte qe ne kete inporte ska pasur foli plastike me elementin AF(Anti Fog).

**Shkresa e mëvonshme e prodhuesit konfirmon vetëm trashësinë 200 µm**

Pas kërkesës për sqarim nga Autoriteti Kontraktues, është dorëzuar një shkresë nga prodhuesi VATAN PLASTIK.

Në këtë shkresë prodhuesi deklaron:

**“As Vatan Plastik, we guarantee that the thickness of the 36 Months greenhouse films produced for Yaprak SHPK is 200 microns.”**

Pra, prodhuesi ka zgjedhur të konfirmojë në mënyrë të qartë dhe konkrete **vetëm trashësinë e folisë prej 200 mikronësh**, Në këtë deklaratë nuk konfirmohet se folia konkrete e prodhuar për YAPRAK SHPK përmban: **UV + EVA + LD + IR + AF.**

Në dokumentin **Technical Data Sheet**, në tabelën “Mechanical Properties”, trashësia është deklaruar: **180 micron**

ndërsa në shkresën e prodhuesit VATAN PLASTIK deklarohet se folia e prodhuar për YAPRAK SHPK është: **200 microns.**

Edhe fatura e paraqitur per inport nga NPT “YAPRAK” përshkruan:

**“Folje (Najlon) 200 micron – UV+IR+AB+LD+EVA, mungon elementi I kerkuar AF.**

Pra kemi së paku tri dokumente që pretendohet se lidhen me produktin, por të cilat nuk krijojnë një zinxhir të njëjtë dhe të verifikueshëm:

**Deklarata e prodhuesit → 200 mic, fatura e inportit → 200 mic qe mungon AF**

Kjo kundërthënie është veçanërisht e rëndësishme sepse TDS-ja që përdoret për të dëshmuar aditivët është për një produkt me trashësi **180 mic**, ndërsa Operatori Ekonomik deklaron se produkti që ofron dhe që prodhuesi ka prodhuar për YAPRAK SHPK është **200 mic**.

Shih dokumentin e dorezuar ne vend te **CETIFIKATES** :

vatan

## Technical Data Sheet

Effective Date: 24.04.2021
Revision Date: -
Revision No: 00

**Product Name** : 36 MONTHS GREEN HOUSE FİLM
**Carrier Type** : Polyethylene
**Product Colour** : Naturel
**Additives** : UV +IR+ AB +EVA+ AF+ LD

**Mechanical Properties:**

| Thickness (One Layer) (micron) ( EN ISO 4591 ) | Dart Drop (g) ( ASTM D1709-09 ) | Elongation ( % ) ( ASTM D 882-10) | | Strenght (N/mm²) ( ASTM D 882-10 ) | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | TD | MD | TD | MD |
| 180 | Avg. 400 | Min. 600 | Min. 400 | Min. 18 | Min. 17 |

**Optical Properties** :

| Total Transmission of Visible Light ( ASTM D 1003) (%) | Total Transmission of Diffused Light ( ASTM D 1003) (%) | UV Transmission ( ASTM D 1003) (%) |
|---|---|---|
| Min.≥ 85 (*) | Min.≥ 40(*) | Min.≥ 9 (*) |

**Chemical Resistances** :

| Sulphur (ppm) | Chlorine(ppm) |
|---|---|
| 1000 (**) | 100 (**) |

**Notes:**

1. The values mentioned on this tecnical data sheet are the result of our analysis and are only provided for reference purposes. The test results can be modified in accordance with the product sizes, differences in extrusion equipment.
2. (*) At a climate of: 150 kly/year.
3. The product should be stored in a closed and dry place before opening the packaging.
4. After opening the package the UV additive becomes effective and protect the product's life during the warranty period.
5. The labels on the roll must be kept by the user during the warranty period.
6. (**) The chemical resistance values refer to the total resistance during the period of use.
7. This tecnical data sheet can not be used as a claim against warranty and does not hold us liable for the unsuccessful use of the product due to specific conditions.

Për këtë arsye, pretendimi ynë është i bazuar në **dokumentet konkrete të ofertës te cilat I kemi dorezuar dhe mund te verifikohet certifkata , DUD dhe** cdo dokumet tjeter nga ana e "Shkelqen Sylaj "BI dhe në mospërputhjen e tyre me kërkesat e Dosjes së Tenderit,

Shih profatuen e cila nuk e permban Nr. Fiscal te **OE "Berisha Construction" Sh.P. K"** Sh.P.K dhe po ashtu edhe Emri I kompanise nuk eshte OE "Berisha Construction" Sh.P.K por Berisha Contraction qe nuk ka te bej me OE te rekomanduar per kontrate .

NPT "YAPRAK"

YAPRAK

MAMUSHE

Nrb:80383959

Nrf:600077665

Tel:029 273 073

Fax:029 273 072

Mob:044 207 204 / 044 415 864

yaprak_mamusa@hotmail.com

DATA: 30.06 2026

*PRO FAKTURA 2026/05*

Per : Berisha Constraction

Adresa: Kline

| No | Artikujte | Njesia | Sasia | Qmimi | Total |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Folje (Najlon) 200 micron UV+IR+AB+EVA+AF+LD | kg | 5.000 | | |

Drejtor:

Cevdet BAYRAKTAR

YAPRAK

Kjo Profature me nrb 80383959 eshte leshuar nga nje kompani e cila sipas verifikimit ne ARBK, eshte e **Shuar.** Nuk mund te kete aktivitete te profatures nje biznes tash me **I shuar.** Ndersa eshte vulosur me vulen e YAPRAK shpk.

Pro Fature 05/2026- folje 200 micron 5000 kg me pershkrim te artikujte e cila nuk nuk eshte sipas kerekses se AK qe ishte ne DT, sepse eshte ndryshe nga kerkessa e AK qe nuk eshte identike me kerkesen e AK, është joreale, e pabesueshme dhe eshte kompani e **Shuar.**

Një profaturë ku një folija eshte pjese shume e rendesishme ne kete aktivtet te prokurimit € nuk mund të pranohet verbërisht si dëshmi valide pa asnjë deshmi konkrete por vetem me nje sqarim nga Operatori ekonomik I cili eshte munduar te arsyetoj duke u thirrur ne nje deklarate te prodhuesit ku kjo deklarate nuk ka qene kerkese e AK-se per me teper kur dihet se Autoriteti kontraktues lidh kontraten me Operatorin ekonomik dhe jo me prodhuesin e folise.
Perveq tjerash AK ka kerkuar sqarim rreth kerkeses se larte cekur DUD-at doganorë dhe nga OE i rekomanduar.

| Kërkesa: | Deshmia: | Kërkohet: |
